

Datë 01.11.2023

Drejtuar: Kryeministrit të Shqipërisë, z. Edi Rama

Përfaqësuesve të institucioneve qendrore dhe vendore, Vlorë dhe Fier

Palëve të interesuara në vend dhe jashtë

Lënda: *Simpozium Ndërkombëtar për Deltën e Vjosës – Një Ekosistem në Tranzicion – Letër e Hapur*

I Nderuar z. Kryeministër,

Të Nderuar znj./z.,

Në emër të Universitetit të Tiranës dhe të gjithë bashkëpunëtorëve të tjerë¹ ju bëjmë me dije se në dt. 27-28 Tetor u mbajt në Vlorë **Simpoziumi Ndërkombëtar për Deltën e Vjosës – Një Ekosistem në Tranzicion**. Në të morën pjesë 45 shkencëtarë nga vendi dhe rajoni (Austri, Itali, Sloveni, Greqi). Gjithsej u mbajtën rreth 20 kumtesa, ku 13 iu kushtuan Deltës, larmisë gjeologjike, gjendjes ekologjike dhe biodiversitetit, gjendjes dhe kërcënimit të tyre. Ekspertët nga rajoni sollën përvojën e tyre mbi rëndësinë e ekosistemeve të tilla tranzitore, shërbimet që ato ofrojnë, standardet që duhet të përmbushen për zhvillimin e qëndrueshëm etj. U ftuan në këtë veprimtari për të shfaqur mendimet e tyre edhe përfaqësues të institucioneve përgjegjëse qendrore dhe vendore.

Aktiviteti u nxit nga përpjekjet dhe shqetësimi i shkencëtarëve nga institucionet tona së bashku me organizatat mjedisore kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me qëndrimin e njeriut ndaj zonës së Deltës së Vjosës. Simpoziumi për Deltën, pasoi së pari një **Javë Shkencore** në Deltë me ekspertë në Prill 2023 për të parë nga afër situatën dhe për të përditësuar më tej njohuritë (gjeologji, gjeografi, biodiversitet, etj.); nxiti prej tyre përgatitjen e një **Vëllimi të posaçëm** ku jepen vlerat natyrore dhe përfitimet (shërbimet) përkatëse, ndjeshmërinë dhe kërcënimet e mundshme për habitatet dhe speciet, si dhe këshillime për ruajtjen dhe ripërtëritjen (në përgatitje e sipër).

Ekspertët theksojnë se **hapësira e Deltës së Vjosës, është ndër më të rëndësishmet dhe më të ruajturat në gjithë Mesdheun, pavarësisht transformimeve natyrore dhe prej njeriut në 60-70 vitet e fundit**. Ajo është një ekosistem tranzitor me rëndësi, si nga ana natyrore, ashtu dhe për shërbimet që ofron për njeriun. Kjo hapësirë, që përfshin dunat dhe ligatinat e Darzezë/Poros, Fier, deri në lagunën e Nartës, Vlorë, është e formuar në qindra vite nga veprimtaria hidrodinamike dhe sedimentologjike e Lumit Vjosë dhe Detit Adriatik. Për këtë, Delta dhe Parku Kombëtar i Lumit të Egër të Vjosës, formojnë një entitet të pandashëm hidrodinamik dhe ekologjik.

Në këtë hapësirë gjenden deri 18 habitate, të listuara si Natura 2000, ku 6 prej tyre janë në përparësi që kërkojnë mbrojtje të veçantë. Këta strehojnë mbi 2,300 lloje të njohura deri

¹ Departamentet e Shkencave të Tokës & Inxhinierisë Gjeologjike dhe Gjeoinformatikës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Universiteti Politeknik i Tiranës; Departamenti i Shkencave Ushqimore dhe Bioteknologjisë, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, Universiteti Bujqësor i Tiranës; Departamenti i Mjedisit, Fakulteti i Planifikimit dhe Mjedisit, Universiteti POLIS, Tiranë, Shqipëri.

sot: rreth 1350 bimë dhe mbi 880 lloje shtazore, ku 240 prej tyre janë shpendë dhe mbi 100 janë peshq. Një pjesë jo e vogël janë lloje të rralla dhe kërcënuara si në shkallë vendi dhe ndërkombëtarisht. Zona renditet si e rëndësishme, si për shpendët (IBA), ashtu dhe për llojet bimore (IPA).

Nga ana tjetër, **qëndrimi i njeriut ndaj kësaj pasurie natyrore nuk ka qënë aspak miqësor për dekada të tëra të Shqipërisë moderne.** Le të listojmë disa: bonifikim në shkallë të gjerë (që nga vitet 1960); shfrytëzim për kripore (që nga vitet 1960); veprimtari industriale në Vlorë (fabrikat e Sodës dhe PVC, 1960-1990); ujërat e zeza të patrajtuara nga Vlora (deri në 2019) dhe qendra të tjera urbane; shfrytëzimi i gazit në Povelçë, Fier (deri në 1990); veprimtaria e portuale (e vazhdueshme) dhe petrolifera (që nga 2009), Vlorë; urbanizim rural i pa kontrolluar (pas viteve 1990); peshkim pa kriter (që nga viti 1990); vjelje pa kriter e amfibëve (që nga vitet 1980), dhe e bimëve mjekësore; bujqësi dhe blegtori jo miqësore (në vazhdimësi); shfrytëzim rëre plazhi (1990-2000); ndërtim rrugësh (në vazhdimësi); zjarre të shpeshta, më i fundit në pyllin Darzezë-Poro në Shtator 2023; termocentrali i Vlorës (97MW), i ndërtuar në vend të gabuar dhe i pa vënë në punë (2010); etj. E gjithë kjo, edhe pse e rëndësishme për ekonominë, është bërë pa u kujdesur si duhet për çështjet mjedisore, duke e detyruar natyrën të kundërvihet herët a vonë, si ndodhi me shkatërrimin e dy plazheve të Patokut dhe Semanit, nga ndërtimet e gabuara në vend të gabuar.

Krahas presionit në të kaluarën, **në vitet e fundit hapësira e Deltës është gjithashtu, edhe nën kërcënimin e zhvillimit të turizmit masiv.** Këto së bashku, çojnë në uljen e integritetit ekologjik, fragmentimin e mëtejshëm të habitateve, humbjen e biodiversitetit dhe varfërimin e shërbimeve që ofron ekosistemi, duke ndikuar si në natyrë dhe te njeriu. Mendimi i ekspertëve është se studimet e kryera janë të pamjaftueshme dhe jo në përputhje me standardet e kërkuara, nuk është vlerësuar si duhet ndikimi i njeriut mbi natyrën, dhe cila mund të jetë prirja e mundshme në rast zbatimi të planeve zhvillimore të parashikuara. Për më tepër, mungon siguria e investimeve në infrastrukturë brenda një Delte shumë dinamike të kushtëzuar nga erozioni galopant detar, që shkakton ndryshime të shpejta të shtrirjes dhe të kontureve të saj. Në këto kushte, mundësia e krijimit të gjurmëve të braktisura të ndërtimeve brenda Deltës së Vjosës nuk është thjesht imagjinare.

Ndaj ne këshillojmë fort:

-Një studim ndërdisiplinor të Deltës së Vjosës me fokus ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të saj, mbështetur në prova shkencore.

-Gjithë gjurma e Deltës së Vjosës të lihet e lirë, e paprekur nga turizmi masiv në shkallë të gjerë dhe të përdoret me mençuri për projekte të turizmit të mbështetur te natyra.

-Është çasti i duhur që Peizazhi i Mbrojtur Pishë Poro – Nartë (kategoria V) të shpallet Park Kombëtar (kategoria II) si pjesë e pandashme e Parkut Kombëtar të Lumit të Egër të Vjosës.

Me respekt

Pjesëmarrës të Simpoziumit dhe më gjerë

Person kontakti: Prof. Aleko Miho, Përgjegjës i Grupit MK të Botanikës, Departamenti i Biologjisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës; aleko.miho@fshn.edu.al; tel. 068.2707208

Vijon me firmat e ekspertëve: